



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 451/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rrustem Thaqi kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur lidhur me apelin e Fatbardha Emini Halabaku nga Vitia, kandidate për deputete nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të datës 07.11.2019, për shkak të mospërputhjes së rezultateve, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 08.11.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.451/2019 i datës 08.11.2019, i paraqitur nga Fatbardha Emini Halabaku nga Vitia, kandidate për deputete nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të datës 07.11.2019, për shkak të mospërputhjes së rezultateve.

A r s y e t i m

Me datë 08.11.2019, kandidatja për deputete nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Fatbardha Emini Halabaku ka paraqitur në PZAP, apelin Anr.451/2019, me të cilën kërkon që në këto vendvotime: 2601D/02D, 2625D/01D, 2501X/08R, 2526D/03R, 0706D/03R, të bëhet përmirësimi i rezultateve sipas FRP, ndërsa në këto vendvotime: 2617D/03R, 2630D/01R, 2630D/02R, kërkon rinumërim të votave për shkak të mos shënimit të saktë të votave në FRP nga komisionerët. Si dëshmi për pretendimet e saj ka bashkangjitur apelit disa foto të formularve të cilat janë të pa qarta dhe nuk vërehen fare.

Në përgjigje në ankesë të datës 08.10.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), thekson se pala ankuese, nuk e ka precizuar mjaftueshëm gjendjen faktike, nuk janë specifikuar arsyet e pengimit të tij që të vëzhgoj procesin e votimit, dhe nuk e ka dëshmuar në ankesën e tij se a ka qenë vëzhgues i akredituar për zgjedhjet e datës 06.10.2019.

Paneli, pasi që shqyrtoj apelin vlerësoi se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mosperputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, Paneli, nuk mundi të konstatoj faktin se ka pasur gabime gjatë rezultateve të publikuara në FRP, në vendvotimet e lartëcekura, ashtu siç pretendohet në apel.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Fatbardha Emini Halabaku e subjektit politik LDK, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë gabim dhe mospërputhje të rezultateve.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.451/2019 më datën 08.11.2019

Kryesuesi i Panelit

Rrustem Thaqi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.